



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Navigim Detar në
Fushën e Mbrojtjes”**

ofruar nga

Akademia e Forcave të Armatosura

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

**Prof. Asoc. Dr. Genta Rexha
Dr. Fatmir Basholli**

Korrik/2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes”**

1	IAL aplikues:	Akademia e Forcave të Armatosura
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 267, datë 19.07.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë (<i>Bachelor</i>)
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	v.a. 2022 – 2023 – 12/0 v.a. 2022 – 2023 – 19/0 v.a. 2023 – 2024 – 9/0
18	Numri i studentëve:	v.a. 2021 – 2022 – 10 studentë v.a. 2022 – 2023 – 9 studentë
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të parë *Bachelor* në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” është hapur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) Nr. 267, datë 19.07.2021, pasi ka kaluar të gjitha fazat e propozimeve dhe miratimit brenda Institucionit.

Ky program është ofruar fillimisht nga Departamenti i Formimit Ushtarak, tashmë pjesë e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit (DTI), në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë (FMS) të Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA), në bashkëpunim me Fakultetin e Studimeve Profesionale (FSP) të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD). Programi ofrohet bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur ndërmjet dy institucioneve, përkatësisht me Nr. 137 datë 01.02.2021 (UAMD) dhe Nr. 383 datë 01.02.2021 (AFA).

Ky program realizohet me 180 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Bachelor” në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, të Akademisë së Forcave të Armatosura, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Programi i studimit të ciklit të parë *Bachelor* në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” është ofruar për herë të parë në vitin akademik 2021 – 2022. Në vitin akademik 2021 – 2022, janë regjistruar 10 studentë dhe në vitin akademik 2022 – 2023, 9 studentë.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Eksperteve të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) përbëhet nga dy anëtarë: Prof. Asoc. Dr. Genta Rexha dhe Dr. Fatmir Basholli, me mbështetjen e koordinatorës së ASCAL, MSc. Rajna Lila.

Procesi i vlerësimit të jashtëm ka filluar në muajin Janar 2025, me dorëzimin nga ana e Akademisë së Forcave të Armatosura të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), si dhe dosjes së vetëvlerësimit (DVV) me dokumentacionin mbështetës.

Ekspertët u njohën me RVB dhe DVV nëpërmjet sistemit të menaxhimit elektronik AMS të ASCAL.

Mbi bazën e një axhende të përcaktuar nga ASCAL në bashkëpunim me AFA, në datat 12 dhe 13 Shkurt 2025, GVJ vizitoi institucionin dhe realizoi një sërë takimesh dhe intervistash me Dekanin e Fakultetit të Mbrojtjes dhe të Sigurisë, Përgjegjës të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të programit, me stafin akademik të programit të studimit, me përfaqësues të Zyrës së Planifikimit, Sigurisë dhe Operacionit, Zyrës së Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë, Zyrës së Shërbimeve Mbështetëse, Zyrës së Burimeve Njerëzore, Zyrës së Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike dhe me studentët e programit të studimit. Gjithashtu, GVJ, zhvilloi vizita në Sekretarinë Mësimore, në Bibliotekë, si dhe u njoh me mjediset e zhvillimit të procesit mësimor.

Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, si dhe të informacionit të mbledhur gjatë vizitës në Institucion.

Akademia e Forcave të Armatosura është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 04.07.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 29 /19 Prot, datë 03.07.2025. Akademia e Forcave të Armatosura njofton në ASCAL më datë 10.07.2025, me anë të shkresës me Nr.2666/1 Prot, datë 10.07.2025 " Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit", ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) është institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare, si dhe strukturë kryesore mbështetëse e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. AFA ka mision arsimimin dhe kualifikimin e personelit ushtarak dhe civil për të gjitha nivelet e drejtimit të Forcave të Armatosura, si dhe të institucioneve të tjera të sigurisë në vend, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, në të tre ciklet e studimit [Evidencë 3, Neni 1, Neni 5].
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bachelor në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” është hartuar në përputhje të plotë me qëllimet dhe misionin e Institucionit, me qëllim përgatitjen e profesionistëve në fushën e navigacionit dhe komandimit detar për mbrojtjen [Evidencë 2, Neni 7].
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me statutin e institucionit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.	Programi i studimit Bachelor në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” është hartuar në përputhje me statutin e institucionit [Evidencë 3], rregulloren e brendshme [Evidencë 7] dhe dokumentin “Politika e arsimit dhe kualifikimit të ushtarakëve të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë për përparimin në gradë” [Evidencë 5]. Ai synon përgatitjen e profesionistëve në fushën e navigacionit dhe komandimit detar për mbrojtjen, në përputhje me standardet kombëtare të arsimit, si dhe standardet e arsimit dhe trajnimit të vendeve të NATO-s [Evidencë 5, Neni 5].
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Programi i studimit Bachelor në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” ofrohet pranë Departamentit të Teknologjisë së Informacionit në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë. Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë ka në përbërje të tij 54 Personel Akademik Efektiv (PAE), 12 Personel Akademik me Kontratë (PAK) dhe 4 Personel Ndihmës Akademik (PNA). Departamenti i Teknologjisë së Informacionit ka në përbërje të tij 7 PAE (1 Prof. Dr., 2 Prof. Asoc., 3 Dr. dhe 1 MSc.) dhe 9




	PAK (1 Prof. Dr., 2 Dr. dhe 6 MSc.) [Tabelat përmbledhëse, Tabela 1, Tabela 2]. Në kuadër të këtij programi studimi janë angazhuar në mësimdhënie në bashkëpunim edhe me FSP, UAMD [Marrëveshje bashkëpunimi UAMD], në v.a. 2022 – 2023, 12 PAE (1 Dr. dhe 11 MSc.), në v.a. 2022 – 2023, 19 PAE (1 Prof. Asoc., 3 Dr. dhe 15 MSc.) dhe në v.a. 2023 – 2024 – 9 PAE (1 Prof. Dr., 1 Dr. dhe 7 MSc.) [Tabelat përmbledhëse, Tabela 6]. Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” ka përvorjen dhe kualifikimin e duhur për ofrimin e tij. <i>Institucioni mund të ndërtojë bashkëpunime me institucione të huaja të ngjashme për të sjellë eksperiencën e tyre në mësimdhënie, veçanërisht për lëndë ku ekspertiza kombëtare është e kufizuar ose mungon.</i>
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit Bachelor në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” ofrohet pranë Departamentit të Teknologjisë së Informacionit në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, në përputhje me fushën e përgjithshme dhe specifike të tyre [Evidencë 10, Evidencë 4.1.1]. <i>Në RVB dhe në DVV nuk ka informacion lidhur me ndjekjen e procedurave nga ana e institucionit për kodifikimin e programit të studimit në zbatim të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022.</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” ofrohet pranë Departamentit të Teknologjisë së Informacionit në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, në përputhje me qëllimet, misionin dhe me fushën e veprimtarisë akademike të institucionit.</i> <i>Ky program studimi ofrohet në bashkëpunim me FSP, UAMD. Kjo sinergji mundëson ofrimin e një programi studimi të standardeve të larta në fushën e navigacionit dhe komandimit detar për mbrojtjen, duke garantuar mbulim të plotë të kompetencave të nevojshme teorike dhe praktike, në përputhje me kërkesat kombëtare dhe ato të vendeve anëtare të NATO-s. GVJ rekomandon institucionin të ndërtojë bashkëpunime me institucione të huaja të ngjashme për të sjellë eksperiencën e tyre në mësimdhënie, veçanërisht për lëndë ku ekspertiza kombëtare është e kufizuar ose mungon.</i>

	<i>GVJ rekomandon ndjekjen nga ana e institucionit të procedurave për kodifikimin e programit të studimit në zbatim të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Organizimi i programit të studimit Bachelor në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” realizohet nga DTI, mbështetur në rregulloren institucionale [Evidencë 7], statutin [Evidencë 3], rregulloren e FMS [Evidencë 4.1], rregulloren e DTI [Evidencë 4.1.1], rregulloren e programit të studimit [Evidencë 2], si dhe të gjithë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Angazhimi i personelit akademik me kohë të plotë, personelit akademik të UAMD në kuadër të bashkëpunimit me këtë institucion [Marrëveshje bashkëpunimi UAMD], si dhe angazhimi i personelit akademik me kontratë bazohet në marrjen e përgjegjësisë respektive dhe vlerësimin e vazhdueshëm të punës së tyre [Evidencë 14].
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Me qëllim realizimin e objektivave të procesit mësimor, AFA bashkëpunon me të gjitha strukturat e tjera të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH) [Evidencë 37]. Në zbatim të urdhrit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, të gjitha strukturat vendosin në dispozicion të AFA të gjitha poligonet stërvitore dhe infrastrukturën e tyre [Evidencë 11]. Për realizimin e objektivave të programit të studimit, AFA ka marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh homologe vendase [Evidencë 15]: Universiteti Politeknik Tiranës, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, Universiteti “Luarasi”, Universiteti “Fan Noli” Korçë, Universiteti “Marlin Barleti”, Akademia e Sigurisë, Qendra e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, , si dhe institucione të huaja: Akademia West Point, Garda New Jersey, Akademi e Forcave të Armatosura, Itali, Akademi e Forcave të Armatosura, Maqedonia e Veriut.




Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale, institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të ndryshme, si: Njësia Ushtarake e Sigurisë Kibernetike, Agjencia e Informacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, Qendra e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, Strukturat ushtarake në vartësi të Shtabit të Përgjithshëm, Strukturat civile në vartësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Në marrëveshjet e bashkëpunimit, si dhe në urdhrin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm është parashtruar edhe mundësia e kryerjes së praktikave mësimore në bashkëpunim me këto institucione [Evidencë 11]. Studentët e këtij programi studimi mund të angazhohen gjithashtu, në trajnime të ndryshme nga NATO, si dhe nga MM dhe SHPPFA për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore në të gjitha strukturat e saj [Evidencë 16].			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	DTI në analizën e tij vjetore përfshin një analizë përmblledhëse të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimit që ofron [Analiza vjetore DTI]. Studentët e programit të studimit Bachelor në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes”, zhvillojnë praktikat profesionale pranë laboratorëve të FMS dhe FSP/UAMD, si dhe në ambientet e enteve publike dhe private sipas marrëveshjeve përkatëse me këto subjekte, ose në subjektin e zgjedhur nga vetë studenti dhe të dakortësuar me personelin akademik, i cili ndjek praktikat [Evidencë 2, Neni 29].			
Konkluzione	<i>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të ndryshme të Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, të cilat mundësojnë shkëmbimin e stafit dhe studentëve.</i> <i>Zhvillimi i praktikave profesionale pranë laboratorëve të FMS dhe FSP/UAMD, si dhe në ambientet e enteve publike dhe private sipas marrëveshjeve përkatëse me këto subjekte, siguron një integrim të drejtpërdrejtë të studentëve në realitetin operativ dhe profesional të fushës së tyre të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nok përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X




II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR


Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” i ofruar nga DTI, pranë AFA, është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) [Evidencë 13].
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit Bachelor në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara dhe aftësi të avancuara teorike dhe praktike në fushën e navigimit detar, sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare. Programi nxit zhvillimin e shprehive profesionale dhe aftësive analitike për të përballuar sfida komplekse dhe të paparashikueshme në mjedisin operacional të Forcave të Armatosura. Studentët zhvillojnë kompetenca në përdorimin e teknologjive moderne, menaxhimin e sistemeve të sigurisë dhe pjesëmarrjen efektive në operacione kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadër të NATO, BE, OKB dhe partnerëve rajonalë. Ky formim shumëdimensional synon të krijojë profesionistë të aftë për të vepruar me efikasitet në fushat e navigimit detar, drejtimit ushtarak dhe menaxhimit të situatave të emergjencës.
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese	Lëndët/modulet janë grupuar sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 me ngarkesën përkatëse në kredite, si më poshtë [Evidencë 13]: - Lëndë bazë (A) – 31 ECTS – 17.2%




duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	- Lëndë karakterizuese (B) – 91 ECTS – 50.5% - Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) – 26 ECTS – 14.4%, - Lëndë plotësuese (D) – 24 ECTS – 13.3%, - Detyrime përmbyllëse (E) – 8 ECTS – 4.4%.
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Si pjesë e lëndëve plotësuese (D) janë parashikuar tre module: Përgatitje fizike – 8 ECTS (gjithsej 120 orë në auditor), Praktikë lundrimore 1 – 7 ECTS (gjithsej 70 orë në auditor), Praktikë profesionale detare 2 – 9 ECTS (gjithsej 90 orë në auditor), gjithsej 24 ECTS. Detyrimet përmbyllëse (E) parashikojnë mbrojtjen e diplomës, gjithsej 8 ECTS (gjithsej 10 orë në auditor) [Evidencë 13].
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Akademia e Forcave të Armatosura (AFA), si institucion i arsimit të lartë me status të veçantë, funksionon në përputhje me ligjin Nr. 80/2015, si dhe aktet nënligjore përkatëse të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Mbrojtjes. Organizimi i studimeve, pranimi i studentëve dhe mënyra e financimit rregullohen përmes një kuadri të posaçëm ligjor, duke marrë parasysh natyrën dhe misionin specifik të institucionit. Ky program realizohet me 180 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Bachelor” në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, të Akademisë së Forcave të Armatosura, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Nga informacionet që GVJ disponon, programe të ngjashme ofrohen nga UAMD, me emërtimin Bachelor në “Navigacion dhe Menaxhim Detar”, dhe nga Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, me emërtimin Bachelor në “Navigacion”.
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	<i>Në RVB dhe në DVV nuk ka informacion mbi kodin përkatës të programit të studimit në zbatim të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022.</i>

Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” ofrohet nga AFA në bashkëpunim me UAMD bazuar në një marrëveshje dypalëshe bashkëpunimi [Marrëveshje bashkëpunimi UAMD].			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” ofron njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për formimin e specialistëve në fushën e navigacionit dhe komandimit detar për mbrojtjen. Ai është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</i> <i>Programi i studimit ofrohet nga AFA në bashkëpunim me UAMD bazuar në një marrëveshje dypalëshe bashkëpunimi.</i> <i>AFA, si institucion me status të veçantë, zhvillon veprimtaritë në përputhje me një kuadër të posaçëm ligjor që rregullon organizimin e studimeve, pranimin dhe financimin, në përputhje me misionin e saj specifik.</i> <i>GVJ rekomandon ndjekjen nga ana e institucionit të procedurave për kodifikimin e programit të studimit në zbatim të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2							
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.							
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve						
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në	Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë përbëhet nga 4 departamente si më poshtë [Tabela përmbledhëse, Tabela 1]:						
	Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë (Viti akademik 2023 - 2024)						
	IAL	Gj	Numri i PAE Tituj/ Grada	Gj	Numri i PAK Tituj/ Grada	Numri i P Ndihmes - Akademi k	Total




legjislacion in në fuqi për organizimi n dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin	Departamenti i Shkencave Ushtarake	12	(0) Prof. Dr. (0) Prof. Asoc. (3) Dr. (0) Dr. Proc. (7) MSc. (1) Mp (1) BSc.	0	(0) Prof. Dr. (0) Prof.Aso c. (0) Dr. (0) Dr.proc. (0) MSc.	0	12
	Departamenti i Marrëdhënie ve Ndërkombëta re dhe i Komunikimit	14	(0) Prof. Dr. (1) Prof. Asoc. (7) Dr. (1) Dr. Proc. (6) MSc.	2	(0) Prof. Dr. (1) Prof. Asoc. (0) Dr. (0) Dr.proc. (1) MSc.	0	16
	Departamenti i Teknologjisë dhe Informacionit	7	(1) Prof. Dr. (2) Prof. Asoc. (3) Dr. (0) Dr. Proc. (1) MSc.	10	(0) Prof. Dr. (1) Prof. Asoc. (2) Dr. (0) Dr.proc. (7) MSc.	0	17
	Departamenti i Gjuhëve të Huaja	21	(0) Prof. Dr. (2) Prof. Asoc. (4) Dr. (1) Dr. Proc. (14) MSc.	0	(0) Prof. Dr. (0) Prof. Asoc. (0) Dr. (0) Dr. Proc. (0) MSc.	4	25
	Në total	54		12		4	70

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI), si pjesë e Fakulteti të Mbrojtjes dhe Sigurisë (FMS), përgjegjëse për programin e studimit *Bachelor* në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes”, ka në përbërje të tij 7 personel akademik efektiv (PAE): 1 Prof. Dr., 2 Prof. Asoc. Dr., 3 Dr., 1 MSc. dhe 9

	personel akademik me kontratë (PAK): 1 Prof. Asoc. Dr., 2 Dr., 6 MSc. [Tabela përmbledhëse, Tabela 2].																								
	Ekuivalentimi i gradave ushtarake me grada dhe titull shkencor, vetëm për efekt te veprimtarisë akademike kryhet sipas VKM Nr. 156 date 19.02.2020, pika 12 [Evidencë 3, Neni 37, pika 7].																								
	<table><tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th><th colspan="2">Departamenti i Teknologjisë së Informacionit</th></tr><tr><th colspan="2">Viti akademik 2023-2024</th></tr><tr><td></td><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>1</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof.Asoc</td><td>2</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr/PhD</td><td>3</td><td>2</td></tr><tr><td>Msc</td><td>1</td><td>6</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>7</td><td>9</td></tr></table>		Kualifikimi i stafit	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit		Viti akademik 2023-2024			PAE	PAK	Prof.Dr	1	1	Prof.Asoc	2	-	Dr/PhD	3	2	Msc	1	6	Gjithsej	7	9
Kualifikimi i stafit	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit																								
	Viti akademik 2023-2024																								
	PAE	PAK																							
Prof.Dr	1	1																							
Prof.Asoc	2	-																							
Dr/PhD	3	2																							
Msc	1	6																							
Gjithsej	7	9																							
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorik	Praktika profesionale në kuadër të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” zhvillohet pranë laboratorëve të FMS dhe FSP/UAMD, si dhe në ambientet e enteve publike dhe private sipas marrëveshjeve përkatëse me këto subjekte, ose në subjektin e zgjedhur nga vetë studenti dhe të dakortësuar me personelin akademik, i cili ndjek praktikën [Evidencë 2, Neni 29]. Praktikën mbikëqyrën nga një person përgjegjës nga Departamenti, i cili mban gradën MSc. ose Dr., si dhe personi në institucionin ku zhvillohet praktika [Evidencë 18].																								




e e klinike, etj.				
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale e në përputhje me objektivat e tij.	Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit [Vendim Koordinatori i Programit], i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale, në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësive kryesore dhe NJBSC mbi ruajtjen e cilësisë dhe standardeve të programit të studimit [Evidencë 2, Neni 13].			
Konkluzione	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI), si pjesë e Fakulteti të Mbrojtjes dhe Sigurisë (FMS), zhvillon veprimtaritë e tij në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi dhe standardet e cilësisë në Arsimin e Lartë, të reflektuara edhe në aktet rregullatore të Institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3




Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve										
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” është hartuar dhe ofrohet nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI), pranë Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë (FMS). DTI disponon të gjitha informacionet e nevojshme për mbarëvajtjen e këtij programi studimi, në përputhje me statutin e institucionit [Evidencë 3], rregulloren e brendshme [Evidencë 7], rregulloren e fakultetit [Evidencë 10], rregulloren e departamentit [Evidencë 4.1.1], dhe rregulloren e programit të studimit [Evidencë 2]. Informacionet janë të disponueshme për të gjithë në “share folder” të Institucionit [Evidencë 22].										
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Në planin mësimor [Evidencë 13] të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes”, si dhe në syllabuset e lëndëve [Evidencë 4.2.2] jepet ngarkesa e studentëve në auditor dhe jashtë tij për çdo aktivitet formues. Frekuentimi/ndjekja e programit përcaktohet në rregulloren e programit të studimit [Evidencë 2, Neni 23], si dhe risillen brenda syllabusit të çdo lënde [Evidencë 4.2.2]: • <i>Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm në masën e përcaktuar nga udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin.</i> • <i>Nëse studenti mungon gjatë zhvillimit të lëndës dhe arrin mbi 25% të mungesave, atëherë studenti skualifikohet dhe nuk mund të marrë pjesë në provimin e ndërmjetëm apo përfundimtar. Sekretaria mësimore informon me shkrim personelin akademik përkatës për studentët që nuk do të marrin pjesë në provim, për shkak të plotësimit të numrit të mungesave.</i> Në çdo syllabus, gjithashtu, jepet informacion i detajuar mbi format e kontrollit të dijës [Evidencë 4.2.2]: • <i>provimi i parë (400 pikë të mundshme),</i> • <i>detyrat e kursit (100 pikë të mundshme),</i> • <i>provimi përfundimtar (500 pikë të mundshme).</i> Në total studenti/ja mund të përfitojë 1000 pikë. Vlerësimi përfundimtar do të bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara dhe përqindjeve përkatëse, si më poshtë [Evidencë 2, Neni 31]: <table><tr><th>Vlerësimi me germë</th><th>Pikë</th><th>Niveli i arritur</th><th>Nota</th><th>Përshkrimi me fjalë</th></tr><tr><td>A+</td><td>96-100</td><td>Shkëlqyeshëm</td><td>10</td><td>Studenti tejkalon standardet</td></tr></table>	Vlerësimi me germë	Pikë	Niveli i arritur	Nota	Përshkrimi me fjalë	A+	96-100	Shkëlqyeshëm	10	Studenti tejkalon standardet
Vlerësimi me germë	Pikë	Niveli i arritur	Nota	Përshkrimi me fjalë							
A+	96-100	Shkëlqyeshëm	10	Studenti tejkalon standardet							

	A	86-95	Shumë mirë	9	Studenti arrin standardet
	B	76-85	Mirë	8	Studenti në tërësi ka arritur standardet
	B+	66-75	Kënaqshëm	7	Studenti pjesërisht arrin standardet
	C	56-65	Mjaftueshëm	6	Studenti ka arritur paksa standardet
	C+	46-55	Kalon	5	Studenti ka arritur minimalisht standardet
	M	≤45	Nuk kalon	4	Studenti nuk ka realizuar të gjitha kreditet e kursit
	P	Studenti për arsye objektive nuk i ka realizuar të gjitha kreditet e kursit.			
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në rregulloren e programit të studimit jepen informacionet e nevojshme lidhur me kriteret e pranimit [Evidencë 2, Neni 16]: <i>Minimalisht kandidati duhet të zotërojë:</i> • <i>Diplomë e maturës shtetërore të përfutur në RSH.</i> • <i>Diplomë e maturës shtetërore e përfutur jashtë dhe e konvertuar në sistemin e arsimimit shqiptar.</i> • <i>Dëshmi/certifikata të njohjes së gjuhëve të huaja.</i> Kritere të tjera • <i>Nota mesatare e shkollës së kryer sipas VKM përkatëse dhe propozimit të njësisë bazë;</i> • <i>Kandidatët e kualifikuar dobët ti nënshtrohen intervistës me gojë;</i> • <i>Kandidatët fitues do të shpallen sipas rendit zbritës të pikëve të llogaritura me formulë sipas kriterëve përzgjedhëse;</i> • <i>Kriteret e veçanta për FA.</i> Kandidatët do të vlerësohen sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe konkursit institucional përmes një sistemi pikësh të përcaktuar [Evidencë 4.18], ku mbahen parasysh pesha specifike e notës mesatare, vlerësimi i testimit fizik, intervista dhe kontrolli shëndetësor. Në rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies [Evidencë 4.16.1, Neni 28] jepen informacione mbi njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e lëndëve: • <i>Njohja e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në AFA bëhet nga njësisia bazë përgjegjëse për programin ose njësisia kryesore, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore.</i>				
Kriteri 4. Programi i studimit përmban	Syllabuset e detajuara të çdo lënde [Evidencë 4.2.2], hartuar në përputhje me shtojcën Nr. 2 të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018, bazuar në planin mësimor të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar				




informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	në Fushën e Mbrojtjes”, risjellin informacionet e nevojshme për studentët lidhur me organizimin e tyre në leksione/seminare/laboratore, si dhe ngarkesën përkatëse brenda dhe jashtë auditorit.			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Gjatë vizitave në institucion, është evidentuar se <i>syllabus</i> -et përditësohen dhe miratohen rregullisht përpara fillimit të çdo viti akademik, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet më të fundit në fushën e studimit. Në këtë program janë regjistruar vetëm dy breza studentësh, pasi AFA ka planifikuar të kalojë drejt një programi të ri katërvjeçar në fushën e navigimit detar në kontekstin e mbrojtjes, në përputhje me modelet e vendeve partnere.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” përmban informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra sipas disiplinave përkatëse, krediteve dhe orëve në auditor dhe jashtë auditorit.</i> <i>Institucioni në aktet e tij të brendshme rregullatore përcakton qartë kriteret e pranimit të studentëve, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e lëndëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Samara

Gent

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” mundëson formimin teorik dhe zhvillimin e aftësive praktike në fushën e navigimit dhe komandimit detar. Përmbajtja e lëndëve dhe praktikave mbështet zhvillimin profesional të studentëve në fusha të tilla si siguria lundruese, ndihma në det (SAR), sistemet e armatimit, komunikimi, menaxhimi dhe logjistika. Programi gjithashtu trajton aspekte të mbrojtjes, të drejtave të njeriut, zhvillimit të qëndrueshëm dhe përdorimit racional të burimeve, duke përgatitur studentët për punësim në sektorin detar dhe për studime të mëtejshme. Emërtimi i programit është në përputhje të plotë me përmbajtjen dhe objektivat e tij akademike dhe profesionale [Evidencë 13].
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) [Evidencë 13]. Viti akademik është i organizuar në semestra.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura aktuale e programit është në përputhje me profilin përkatës të studimit dhe me programe të ngjashme ndërkombëtare, duke adresuar kërkesat e tregut të punës kombëtar dhe ndërkombëtar dhe duke mundësuar punësim të shpejtë të studentëve në këtë fushë. Në këtë kuadër, AFA ka planifikuar një hap të mëtejshëm zhvillimi, duke synuar kalimin drejt një programi katërvjeçar në fushën e navigimit detar në kontekstin e mbrojtjes, në përputhje me modelet e vendeve partnere.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” është strukturuar në mënyrë që të garantojë një ndërthurje të balancuar midis formimit teorik dhe atij praktik, duke mbështetur arritjen e objektivave formues të programit. Kjo qasje mundëson jo vetëm përvetësimin e njohurive të thelluara akademike, por edhe zhvillimin e aftësive praktike të domosdoshme për fushën e navigimit dhe mbrojtjes. Ndërtimi




studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	i programit është frymëzuar nga përvojat më të mira të universiteteve dhe akademive ushtarake në vendet e NATO-s, duke lehtësuar kështu transferimin e studimeve, mobilitetin akademik dhe punësimin e studentëve pas diplomimit, si në tregun vendas, ashtu edhe në atë ndërkombëtar [Evidencë 25].			
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	DTI angazhohet në përditësimin e vazhdueshëm të <i>syllabus</i> -eve të lëndëve, me qëllim që përmbajtja e tyre të jetë në përputhje me zhvillimet më të fundit të fushës dhe kërkesat e tregut të punës. Përgjegjësi i Departamentit, në bashkëpunim me titullarët e lëndëve, shqyrton në mënyrë periodike përmbajtjen e <i>syllabus</i> -eve për çdo semestër, duke u siguruar që literatura bazë dhe ndihmëse të jetë bashkëkohore dhe e përditësuar, kryesisht nga vitet e fundit [Evidencë 27].			
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” u mundëson dhe u garanton studentëve përfitim të dijeve, fitimin e aftësive dhe kompetencave, për t’u punësuar brenda dhe jashtë vendit në fushën e navigacionit dhe komandimit detar për mbrojtjen.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.	Përmbajtja e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” është në përputhje me nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe mundëson ndjekjen në vazhdim të studimeve të ciklit të dytë <i>Master Profesional</i> dhe <i>Master i Shkencave</i> në përputhje me profilin e studimit.			
Konkluzione	<i>Organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” ofron një formim të plotë për studentët, përmes një ndërthurjeje të njohurive teorike dhe aftësive praktike. Programi është në përputhje me zhvillimet më të fundit teknologjike në këtë fushë dhe mbështetet në literaturë bashkëkohore, duke mundësuar integrimin e shpejtë të studentëve në tregun e punës, si dhe vijimin e studimeve në ciklin e dytë, në programe të nivelit Master Profesional ose Master i Shkencave.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Nisur nga konsultimet me institucionet partnere kombëtare dhe ndërkombëtare, AFA ka planifikuar të kalojë drejt një programi të ri katërvjeçar në fushën e navigimit detar në kontekstin e mbrojtjes.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Institucioni mban kontakte të vazhduara me studentët, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit të programit të studimit dhe pedagogëve gjatë orëve të mësimin, si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor [Evidencë 73]. Diskutimet dhe propozimet me studentët alumni janë të hapura dhe konstante në kuadër të përmirësimit të programeve të studimit apo shkëmbimit të eksperiencave.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	AFA ka planifikuar të kalojë drejt një programi të ri katërvjeçar në fushën e navigimit detar në kontekstin e mbrojtjes, në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit të fushës, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet partnere kombëtare dhe ndërkombëtare për të siguruar një formim të avancuar dhe të përshtatur me kërkesat e tregut dhe standardet ndërkombëtare.




Konkluzione	<i>Institucioni nxit përfshirjen e studentëve dhe institucioneve partnere në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit të ofruara, duke dëshmuar një përmirësim të vazhduar të ofertës së tij akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Ascal

Paul 29

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” është i organizuar dhe veprimtaria mësimore zhvillohet me një kohëzgjatje prej 3 vitesh në 6 semestra. Ngarkesa në auditor e studentëve [Tabela përmbledhëse, Tabela 13] është e organizuar në leksione (885 orë), seminare (410 orë), ushtrime/laboratorë (537 orë), forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor (104 orë) dhe udhëheqje teze diplome/konsultime për provimin përfundimtar të formimit (10 orë), gjithsej 1946 orë.
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Mësimdhënia në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” është kombinim i njohurive teorike me një komponent të fortë të praktikës profesionale [Evidencë 13], e cila synon të vendosë studentët në situata reale me të cilat do të ndeshen gjatë aktivitetit të tyre profesional. Personeli akademik ka vëmendje të veçantë në përshtatjen e metodave të mësimdhënies në përputhje me nevojat e studentëve dhe me teknologjitë bashkëkohore të mësimdhënies [Evidencë 33].
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Institucioni angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimin e kompetencave didaktike të personelit akademik, në funksion të arritjes së rezultateve të pritshme të të nxënit. Në këtë kuadër, është hartuar një udhëzues strategjik për zhvillimin dhe zbatimin e metodave bashkëkohore dhe inovative të mësimdhënies, i cili shoqërohet me një program të dedikuar për zhvillimin pedagogjik dhe didaktik të stafit. AFA organizon trajnime periodike për personelin akademik, në fillim të vitit akademik dhe gjatë periudhës ndërmjet semestrave [Evidencë 36]. Gjithashtu, institucioni inkurajon dhe mbështet pjesëmarrjen e stafit në programe ndërkombëtare shkëmbimi, konferenca, seminare, si dhe në projekte kërkimore dhe botime shkencore, duke mundësuar përvetësimin dhe aplikimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në procesin mësimor [Evidencë 37; Evidencë 40].




Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” është i angazhuar në mësimdhënie staf akademik i kualifikuar, me eksperiencë akademike dhe profesionale të fituar ndër vite gjatë punës në universitete dhe në Institucione të tjera të profilin, duke sjellë eksperiencën e tyre si mësimdhënës në AFA [Tabelat përmbledhëse, Tabela 6]. Pedagogët përdorin metoda interaktive gjatë zhvillimit të lëndëve me qëllim arritjen e bashkëpunimit, si dhe përmirësimin e njohurive duke futur edhe koncepte të reja nga fusha teknologjike dhe ajo e zbatimit të tyre për të nxitur interesin dhe vullnetin e studentëve.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	DTI kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Në këtë kuadër një rëndësi të veçantë kanë edhe sugjerimet që vijnë nga studentët dhe të diplomuarit përmes kontakteve me ta, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinators të programit të studimit dhe pedagogëve gjatë orëve të mësimin, si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor [Evidencë 73]. Institucioni praktikon gjithashtu vizita në auditor nga drejtuesi i departamentit dhe dekani, me qëllim vëzhgimin e drejtëpërdrejtë të metodave të mësimdhënies të përdorura nga pedagogët dhe vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor [Evidencë 41].
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse	Në AFA funksionon NJBSC [Evidencë 43], e cila në bashkëpunim me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave dhe njësitë bazë dhe kryesore, luan një rol kyç në koordinimin e aktiviteteve për përmirësimin e mësimdhënies. Këto struktura janë të angazhuara në vlerësimin e performancës së personelit akademik përmes pyetësorëve të studentëve [Evidencë 73] dhe vizitave në auditor nga drejtuesi i departamentit dhe dekani [Evidencë 41]. Vlerësimet e mbledhura përdoren për të hartuar programe të përshtatura trajnimi, që zhvillohen rregullisht në fillim të vitit akademik dhe gjatë ndërprerjes ndërmjet semestrave [Evidencë 36]. Institucioni mbështet gjithashtu eksperimentimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies [Evidencë 33], të cilat trajtohen në mënyrë të




mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	vazhdueshme në takimet e drejtuesve institucionalë me stafin akademik, duke nxitur një qasje moderne dhe efektive ndaj procesit mësimor.		
Konkluzione	<i>AFA kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Institucioni nxit dhe mbështet stafin akademik në zhvillimin e mësimdhënies me metoda bashkëkohore, në përputhje me programin e studimit, në përshtatje me tregun e punës duke e bërë programin tërheqës për studentët.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Në rregulloren e programit të studimit [Evidencë 2, Neni 31] dhe në syllabuset e lëndëve [Evidencë 4.2.2] jepen kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive, të cilat janë publike dhe vihen në dispozicion të studentëve.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në	Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen, në programin e lëndës dhe të Praktikës Profesionale [Evidencë 4.2.2] dhe i bëhen të ditura studentëve në orën e parë të mësimit [Evidencë 2, Neni 31]. Titullari/Pedagogu i lëndës në fillim të semestrit, gjatë orës së parë të mësimit, njeh studentët me syllabusin e lëndës, temat që do të trajtohen, veprimtaritë sipas

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Hamana

Gjuri

syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	të cilave është organizuar mësimi, si dhe format e kontrollit të dijeve.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Në rregulloren e programit të studimeve [Evidencë 2, Neni 31] përshkruhen format e ndryshme të kontrollit të dijeve. Këto përshkruhen në mënyrë më specifike në përputhje me kërkesat e lëndës edhe në syllabuset e lëndëve [Evidencë 4.2.2]: 1. Format e kontrollit të dijeve janë provimi me shkrim, me gojë, me detyra kursi/projekte, i kombinuar, me kontroll dhe vëzhgim; 2. Vlerësimi në një lëndë dhe në Praktikën Profesionale mund të bëhet: i. me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar; ii. me detyra kursi, projekte; iii. me kontroll dhe vëzhgim. 3. Për çdo lëndë 10% e vlerësimit bazohet në detyrat e kursit, projektet individuale apo në grupe, esetë, maketet, etj, sipas programit të lëndës së miratuar. 4. Në të gjitha format e kontrollit të lëndëve dhe të Praktikës Profesionale përdoret sistemi i vlerësimit me 1000 pikë, vlera përkatëse detyrimisht konvertohet (kthehet) në notë sipas formulës së përcaktuar me vendim të Senatit Akademik.
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	DTI kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Në këtë kuadër një rëndësi të veçantë kanë edhe sugjerimet që vijnë nga studentët dhe të diplomuarit përmes kontakteve me ta, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit të programit të studimit dhe pedagogëve gjatë orëve të mësimi, si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor [Evidencë 73].
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te	Personeli akademik i programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” përdor metoda interaktive si punë në grup, simulime, projekte, diskutime dhe prezantime, që ndihmojnë në zhvillimin e njohurive dhe kompetencave të studentëve. Mësimdhënia është e orientuar drejt studentit, duke e vendosur atë në qendër të të nxënit, ndërsa pedagogët veprojnë si mbështetës të procesit. Kjo qasje nxit pjesëmarrjen aktive dhe diskutimet në auditor, duke e bërë mësimin më tërheqës dhe efektiv.

studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.				
Konkluzione	<i>Institucioni në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përcakton procedurat e testimit dhe vlerësimit të njohurive të fituara nga studentët për çdo lëndë, duke garantuar aftësimin e tyre në përputhje me objektivat e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3				
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi përfundimtar i çdo lënde kryhet duke u bazuar në shumën e pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të lëndës (maksimalisht 1000 pikë) si më poshtë [Evidencë 2, Neni 31]:			
	• provimi i parë (400 pikë të mundshme), • detyrat e kursit (100 pikë të mundshme), • provimi përfundimtar (500 pikë të mundshme).			
	Në total studenti/ja mund të përfitojë 1000 pikë. Vlerësimi përfundimtar do të bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara dhe përqindjeve përkatëse, si më poshtë:			
	Vlerësimi me germë	Pikë	Niveli i arritur	Nota
	A+	96-100	Shkëlqyeshëm	10
	A	86-95	Shumë mirë	9
	B	76-85	Mirë	8
	B+	66-75	Kënaqshëm	7
	C	56-65	Mjaftueshëm	6
Përshkrimi me fjalë				
Studenti tejkalon standardet				
Studenti arrin standardet				
Studenti në tërësi ka arritur standardet				
Studenti pjesërisht arrin standardet				
Studenti ka arritur paksa standardet				

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	C+	46-55	Kalon	5	Studenti ka arritur minimalisht standardet
	M	≤45	Nuk kalon	4	Studenti nuk ka realizuar të gjitha kreditet e kursit
	P	Studenti për arsye objektive nuk i ka realizuar të gjitha kreditet e kursit.			
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni nuk disponon sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të njohurive.				
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me rregulloren e programit të studimit [Evidencë 2, Neni 31] dhe syllabuset e lëndëve [Evidencë 4.2.2] sipas përcaktimeve në Standardin III.3, Kriteri 1.				
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i të gjithë komponentëve — pjesëmarrja aktive në seminare, detyra e kursit, testi ndërmjetës dhe ai final — shoqërohet me komente dhe <i>feedback</i> të detajuar nga pedagogët. Pas testeve ndërmjetëse dhe përfundimtare, organizohet një seancë sqaruese me studentët, ku shpjegohen qartë kriteret e vlerësimit dhe u jepet mundësia të ballafaqohen me rezultatet dhe cilësinë e provimeve të tyre [Evidencë 2, Neni 26].				
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik	Në përputhje me rregulloren mësimore [Evidencë 2, Neni 27]: 1. Gjatë provimit nuk lejohet të komunikohet me asnjë person tjetër, përveçse me personelin akademik të lëndës.				




shëmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	2. Nuk lejohet përdorimi i celularit apo i çdo mjeti tjetër komunikimi ose regjistrimi. 3. Nuk lejohet përdorimi i asnjë materiali mësimor përveç materialeve të lejuara nga personeli akademik i lëndës. Personeli akademik informon studentët dhe asistuesin për materialet që studentët mund të përdorin përpara fillimit të provimit. 4. Në rast se studenti thyen rregullat e provimit, ai ndërpret provimin dhe plotësohet procesverbali për parregullsi në provime nga personeli akademik i lëndës dhe asistuesi përkatës. Gjithashtu procesverbalit i bashkëngjitet provimi i cili vlerësohet me 0 pikë. Procesverbali duhet të jetë sipas formatit në aneksin bashkëngjitur rregullores. Kur studentit i plotësohet procesverbal për parregullsi në provime, ai nuk lejohet t'a japë lëndën në sezonin e riprovimeve, por duhet ta frekuentojë përsëri atë.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Në rastin e provimit përfundimtar, personeli akademik i lëndës cakton datën dhe orën për të bërë të ditur rezultatet e provimit. Dita e vendosur prej personelit akademik duhet të jetë jo më vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar. Personeli akademik duhet të pasqyrojë në sistem rezultatet brenda afateve të mësipërme [Evidencë 2, Neni 26].
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin. Ankesa i drejtohet me shkrim Drejtuesit të Njesisë Kryesore ku bën pjesë studenti jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. Drejtuesi i FMS kur e sheh të arsyeshme i kalon për shqyrtim kërkesën Përgjegjësit të Departamentit përkatës. Përgjegjësi i Departamentit, i cili vë në dijeni dhe personelin akademik të lëndës, pas shqyrtimit të kërkesës dërgon tek Drejtuesi i FMS një relacion shpjegues. Në bazë të relacionit Drejtuesi i FMS vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës së studentit. Në rastin kur kërkesa refuzohet studenti njoftohet për këtë vendim dhe për arsyet e refuzimit. Në rastin kur kërkesa miratohet, Dekani ngre një komision <i>ad-hoc</i> për rishikimin e tezës nëse lënda mbulohet nga vetë Departamenti. Në rast se lënda mbulohet nga një Njësi tjetër Kryesore, Drejtuesi i Njesisë Kryesore i kërkon kësaj njësie përbërjen e komisionit të ngritur nga Drejtuesi i asaj njësie. [Evidencë 2, Neni 28]




Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Përgjegjësi i Departamentit përcakton ditën dhe orën se kur do mbledhet komisioni <i>ad-hoc</i> jo më vonë se 3 ditë nga miratimi i kërkesës dhe njofton për këtë orar personelin akademik të seksionit/grupit mësimor dhe studentin. Rishikimi i tezës nga komisioni <i>ad-hoc</i> realizohet në prezencë të studentit dhe personelit akademik të seksionit/grupit mësimor, nëse këta paraqiten në orarin e përcaktuar. Në përfundim të procesit, komisioni mban një procesverbal të veçantë ku pasqyron vendimin e tij për të ndryshuar ose jo vlerësimin e provimit së bashku me arsyetimin përkatës. Në rast se ka ndryshim në vlerësimin e provimit atëhere ky ndryshim duhet të pasqyrohet në procesverbalin e lëndës duke ndjekur procedurat e përcaktuara në këtë rregullore. [Evidencë 2, Neni 28]			
Konkluzione	<i>DTI në rregulloren e programit të studimit përcakton procedura të qarta dhe transparente të vlerësimit të njohurive të studentëve të bazuara në meritë, si dhe ju jep mundësinë studentëve të ankimojnë vlerësimin, duke ngritur komisione ad hoc për shqyrtimin e ankimit. Institucioni kujdeset në zhvillimin e aktiviteteve vlerësuese të dijeve me korrektesë, duke mos pranuar kopjen dhe plagjiaturën nga ana e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” është konceptuar për të garantuar marrjen e njohurive teorike dhe praktike në fushën e navigimit, sigurisë detare dhe mbrojtjes kombëtare. Programi synon zhvillimin e aftësive profesionale dhe kompetencave të veçanta, përmes përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies, punës praktike në laboratorë, simulimeve, si dhe përfshirjes në skenarë realë operacionalë të Forcave të Armatosura. Studentët përgatiten për të përballuar sfida komplekse në mjedise të paparashikueshme, duke u pajisur me aftësi analitike, menaxhuese dhe teknike. Gjithashtu, programi siguron zotërimin e njohurive për përdorimin e teknologjive të avancuara dhe aftësinë për të kontribuar në operacione të përbashkëta në kuadër të NATO, BE, OKB dhe strukturave të




	tjera ndërkombëtare, duke formuar profesionistë të kualifikuar në drejtimin detar dhe ushtarak.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Natyra e kompetencave të kërkuara në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e komunikimit dhe ndërveprimit duke qenë se sektori detar në fushën e mbrojtjes është në mënyrë të pashmangshme i lidhur me rrjetin ndërkombëtar, kërkon njohje të gjuhës së huaj, si dhe një komunikim intensiv duke shfrytëzuar elementë të avancuar të teknologjisë së informacionit.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Gjatë orëve të fundit të mësimit, studentët dorëzojnë detyrat e kursit, punët e laboratorëve, apo zhvillojnë seanca përmbledhëse ushtrimesh, përmes të cilave testojnë njohuritë e marra dhe vetëvlerësojnë përgatitjen e tyre përpara provimit përfundimtar. Në fund të lëndës, bëhet një përmbledhje e argumentave kryesorë dhe diskutim i situatave reale mbi temat e trajtuara [Evidencë 4.2.2].
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet	Kurrikula e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” [Evidencë 13] është hartuar duke ndërthurur orët teorike në auditor me orët praktike në laboratore, dhe praktikën mësimore, duke mundësuar zhvillimin tek studentët e kompetencave profesionale në fushën e detarisë dhe mbrojtjes kombëtare. Një pjesë e detyrave të kursit zhvillohen në grup, me qëllim nxitjen e punës në grup, aftësimin në ndarjen e detyrave, ballafaqimin e rezultateve dhe diskutimin e tyre. AFA mbështet idetë inovatore të studentëve, krijon mundësi për zbatime të avancuara dhe mbështet financiarisht projekte kërkimore të suksesshme nëpërmjet strukturave të saj në mënyrë të veçantë me Qendrën e Inovacionit Sigurisë dhe Mbrojtjes [Evidencë 48].




bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.				
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm të programit të studimit, të përzgjedhur për ekspertizën e tyre të spikatur në fusha specifike, përveç mësimdhënies angazhohen edhe në veprimtari shtesë si seminare, workshope dhe prezantime në auditore të zgjeruara. Në këto aktivitete marrin pjesë jo vetëm studentët e programit përkatës, por edhe studentët dhe pedagogë nga programe të tjera studimi brenda fakultetit apo fakulteteve të tjera [Evidencë 62].			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” është hartuar duke ndërthurur orët teorike në auditor me orët praktike në laboratore, dhe praktikën mësimore, duke mundësuar zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale të studentëve në fushën e detarisë dhe mbrojtjes, duke i përgatitur ata për sfidat reale të profesionit dhe për integrimin në tregun e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Në rregulloren e programit të studimit është përcaktuar procedura për zhvillimin e provimit të përgjithshëm përfundimtar [Evidencë 2, Neni 34]: 1. Vlerësimi për provimin e përgjithshëm përfundimtar të formimit/diplomimit bëhet nga një komision, përbërja e të cilit propozohet nga DTI dhe miratohet nga Dekani. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë. 2. Nota përfundimtare llogaritet si mesatare e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit, të cilat pasqyrohen në procesverbal, dhe i bëhet e ditur studentit nga Komisioni, jo më vonë se 72 orë nga përfundimi i provimit. 3. Lëndët që do të përfshihen, si dhe formati i tezës së provimit të formimit të diplomimit përcaktohen nga DTI sipas specifikave të programit të studimit Bachelor në "Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes".




	4. Studenti që kalon me sukses mbrojtjen e tezës së diplomës/provimin e përgjithshëm përfundimtar të formimit pajiset me diplomën përkatëse.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Personeli akademik i programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” ofron mbështetje të vazhdueshme për studentët, duke i informuar dhe udhëzuar rregullisht lidhur me materialet e nevojshme për përgatitjen e temës së diplomës. Për studentët që ndjekin rrugën e provimit përfundimtar të përgjithshëm, departamenti siguron informim të detajuar mbi strukturën e tezës së provimit, natyrën e pyetjeve, si dhe kriteret dhe standardet e vlerësimit. Zhvillohen gjithashtu, seanca mbështetëse për të ndihmuar studentët në përgatitjen e këtij provimi, duke siguruar orientimin e nevojshëm akademik.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Komisioni i ngritur për vlerësimin e testeve në provimit përfundimtar të përgjithshëm, vlerëson formimin e përgjithshëm të studentëve përgjatë tre viteve akademike duke u bazuar në rregulloren e FMS [Evidencë 10] dhe AFA [Evidencë 7, Neni 66].
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orientojnë dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Personeli akademik i programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” udhëzon studentët mbi temat e mundshme të tezës së diplomës, bazuar në fushat përkatëse të ekspertizës. Studentët zhvillojnë takime periodike me udhëheqësit akademikë dhe departamentin për të sqaruar paqartësitë lidhur me temat e përcaktuara. Në përfundim të punës së diplomës, studentin dorëzon në sekretarinë mësimore kopjet fizike të nënshkruara nga udhëheqësi dhe një kopje elektronike në format PDF [Evidencë 74].

Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Studentët e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” marrin mbështetje të vazhdueshme nga stafi akademik, veçanërisht nga udhëheqësit e temave të diplomës, në çdo fazë të përgatitjes së saj [Evidencë 74].
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Nota përfundimtare llogaritet si mesatare e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit, të cilat pasqyrohen në procesverbal, dhe i bëhet e ditur studentit nga Komisioni, jo më vonë se 72 orë nga përfundimi i provimit [Evidencë 2, Neni 34].
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomë <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, të Akademisë së Forcave të Armatosura, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit.
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	FMS ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.
Konkluzione	<i>Në rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” përcaktohet procedura për zhvillimin e provimit të formimit/mbrojtjes së diplomës. Në bazë të kriterit të notës mesatare, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar formimi. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomë Bachelor në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, të Akademisë së Forcave të Armatosura, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</i>

	<i>Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1								
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.								
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve							
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Në kuadër të këtij programi studimi janë angazhuar në mësimdhënie në bashkëpunim edhe me FSP, UAMD [Marrëveshje bashkëpunimi UAMD], në v.a. 2021 – 2022, 12 PAE (1 Dr. dhe 11 MSc.), në v.a. 2022 – 2023, 19 PAE (1 Prof. Asoc., 3 Dr. dhe 15 MSc.) dhe në v.a. 2023 – 2024 – 9 PAE (1 Prof. Dr., 1 Dr. dhe 7 MSc.) [Tabelat përmbledhëse, Tabela 6]. Stafit akademik i angazhuar në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” ka përvojën dhe kualifikimin e duhur për ofrimin e tij.							
	Për tre vite akademike të dhënat e stafit për program studimi vijojnë si më poshtë:							
	Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit	2021-2022		2022-2023		2023-2024		
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	
		Prof.Dr	-	-	-	-	1	-
		Prof.As.Dr	-	-	1	-	-	-
		Dr	1	-	3	-	1	-
		MSc	11	-	15	-	7	-
Total	12	0	19	0	9	0		
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Ngarkesa mësimore në këtë program studimi mbulohet 100% nga personel akademik efektiv (PAE) [Tabelat përmbledhëse, Tabela 12], në përputhje me VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 ku citohet: “Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për cdo program studimi”. <i>Institucioni mund të shfrytëzojë ekspertizën e jashtme brenda 30% të ngarkesës sipas parashikimeve në VKM Nr. 418, datë 10.05.2017.</i>							
	Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit,							
Institucioni lidh kontrata të punësimit të personelit akademik efektiv (civil), në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, në të cilat parashikohet mbulimi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore [Evidencë 56]. Nga të dhënat e vëna në dispozicion në DVV vihet re një qëndrueshmëri e stafit ndër vite [Tabelat përmbledhëse, Tabela 6].								

Kamran

Gjend

për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Procesi i punësimit dhe emërimit realizohet me procedurë konkurrimi të hapur, duke garantuar transparencë, paanshmëri dhe objektivitet. Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për vendet e lira të punës, propozohen nga përgjegjësi i departamentit përkatës, pas konsultimit me anëtarët e departamentit dhe publikohen në faqen zyrtare të institucionit: https://www.mod.gov.al/newsroom-2/njoftime/6378-shpallje-vendi-i-lire-pune-pedagog-per-informatiken-rep-usht-5002-fakulteti-i-mbrojtjes-dhe-sigurise-ne-afa . Stafi akademik në AFA angazhohet si staf akademik me kohë të plotë dhe staf akademik me kohë të pjesshme, civil ose ushtarak në funksion të nevojave të programeve të studimit që ai ofron [Evidencë 55].
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Nisur nga të dhënat e vëna në dispozicion në DVV, Institucioni nuk ka angazhuar staf ndihmës akademik në kuadër të këtij programi studimit. Këto nevoja mbulohen nga bashkëpunimi me UAMD [Marrëveshje bashkëpunimi UAMD].
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.	Zyra e Burimeve Njerëzore/DAK është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme) si dhe atij administrativ. Për secilin punonjës krijohet Dosja Individuale, ku arkivohet i gjithë dokumentacioni përkatës. Gjithashtu, kjo zyrë mban evidencë të ngarkesës mësimore të stafit akademik për çdo semestër.




Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Praktika profesionale në kuadër të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” zhvillohet pranë laboratorëve të FMS dhe FSP/UAMD, si dhe në ambientet e enteve publike dhe private sipas marrëveshjeve përkatëse me këto subjekte, ose në subjektin e zgjedhur nga vetë studenti dhe të dakortësuar me personelin akademik, i cili ndjek praktikën [Evidencë 2, Neni 29]. Praktikën mbikëqyrjen nga një person përgjegjës nga Departamenti, i cili mban gradën MSc. ose Dr., si dhe personi në institucionin ku zhvillohet praktika [Evidencë 18].
Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Në rregulloren e programit të studimit [Evidencë 2, Neni 29] përcaktohet si më poshtë: 1. Praktika Profesionale zhvillohet në përputhje me programin e saj, në bazë të një grafiku të hartuar nga personeli akademik që ndjek Praktikën Profesionale të dakortësuar me Koordinatorin e programit përkatës të studimit. 2. Praktika Profesionale zhvillohet në laboratorët e FMS dhe FSP/UAMD si dhe në ambientet e enteve publike dhe private sipas marrëveshjeve përkatëse me këto subjekte, ose në subjektin e zgjedhur nga vetë studenti e të dakortësuar me personelin akademik ndjekës të praktikës Stafi i caktuar për mbikëqyrjen e praktikave mësimore mbështet studentët në hartimin e raportit përfundimtar të praktikës dhe merr pjesë në procesin e vlerësimit të tyre [Evidencë 18].




Konkluzione	<i>Në programin e studimit Bachelor në "Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes" është angazhuar personel akademik efektiv në përputhje me legjislacionin në fuqi, nevojat dhe specifikat e programit.</i> <i>Institucioni ka një procedurë të qartë dhe transparente të rekrutimit dhe të vlerësimit duke garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën e programeve të studimit.</i> <i>Bashkëpunimi me ente të ndryshme, të cilat zhvillojnë aktivitetet e tyre në fushën e navigacionit dhe komandimit detar për mbrojtjen mundëson realizimin korrekt të praktikave profesionale të studentëve.</i> <u>GVJ rekomandon shfrytëzimin e ekspertizës së jashtme brenda 30% të ngarkesës sipas parashikimeve në VKM Nr. 418, datë 10.05.2017.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Institucioni disponon 8 godina, në të cilat vihen në dispozicion të studentëve 18 klasa dhe 5 salla për mësim, 7 laboratore, hotel, mensë, palestër, bibliotekë, të cilat plotësojnë kushtet për zhvillimin korrekt të veprimtarive mësimore [Evidencë 59].			
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik	Ambientet mësimore janë pajisur me infrastrukturë të teknologjisë së informacionit duke mundësuar realizimin e procesit mësimor në përputhje me metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies [Evidencë 34]. 11 klasa janë të pajisura me PC dhe projektorë, në bibliotekë janë të instaluar për përdorim nga studentët 30 PC dhe 1 printer. Godina ofron mbulim të plotë me rrjet Wi-Fi dhe studentët kanë akses të plotë në rrjetin LAN. Kjo infrastrukturë mundëson përdorim të pavarur, si nga studentët, ashtu edhe nga stafi			

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gim. "Q. Stafa", Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	akademik, në funksion të procesit mësimor dhe për veprimtari kërkimore-shkencore.			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, ateliët apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Në funksion të programit të studimit <i>Bachelor</i> në "Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes" vihen laboratorët dhe ambientet mësimore të AFA dhe UAMD, të cilët mundësojnë realizimin korrekt të procesit mësimor, në përputhje me kërkesat specifike të programit.			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Institucioni ka në dispozicion 2 laboratorë modern të teknologjisë së informacionit të pajisur me rreth 60 laptop me parametra bashkëkohore dhe me programe profesionale në përputhje me kërkesat e programit të studimit [Evidencë 34].			
Konkluzione	<i>FMS ka në dispozicion ambiente me pajisjet e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore të programit të studimit Bachelor në "Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes", duke mundësuar realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik përmes përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Hamani

Gent

Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Në bibliotekën mësimore të FMS vihen në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes”, në format fizik dhe elektronik pa pagesë, literaturë bazë dhe ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, në përputhje me syllabuset e lëndëve [Evidencë 4.2.2], të cilat garantojnë marrjen e njohurive të parashikuara në programin e studimit. Pedagogët e lëndëve kujdesen të përgatisin materiale mësimore të përditësuara në gjuhën shqipe, të cilat vihen në dispozicion të studentëve.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	DTI kujdeset në përditësimin e syllabuseve të lëndëve [Evidencë 4.2.2] në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe literaturën bashkëkohore në fushën e studimit.
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore. Në bibliotekë janë instaluar 30 PC për përdorim nga studentët. Përmes kompjuterave në bibliotekë, studentët mund të aksesojnë libraritë <i>online</i> të vëna në dispozicion nga Institucioni dhe librat në format elektronik [Evidencë 35]. Institucioni kujdeset në përditësimin e literaturës në dispozicion në bibliotekë, në përputhje me përditësimet më të fundit në syllabuset e lëndëve [Evidencë 27].
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Institucioni në bibliotekën e tij qendrore vë në dispozicion të studentëve 8630 tituj librash dhe 20 vende leximi [Evidencë 59]. Nisur nga bashkëpunimi me RASH [Evidencë 52] funksionon libraria <i>online</i> EBSCO. Literatura në dispozicion në bibliotekë në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja është e mjaftueshme dhe në përputhje me fushat specifike që AFA mbulon. Librat fizikë janë skanuar dhe vihen në dispozicion të studentëve elektronikisht në rrjetin e brendshëm të Institucionit duke mundësuar aksesimin e tyre në çdo kohë nga ana e studentëve.
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Biblioteka mësimore e AFA dhe fondi i literaturës fizike dhe elektronike në dispozicion të saj garantojnë shfrytëzimin në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes”. Ky shërbim është pa pagesë dhe pa asnjë kufizim në kohë për studentët e AFA brenda ambjenteve të institucionit.




Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka e AFA është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. Në funksion të saj janë vendosur 30 njësi desktop, që mund të aksesohen nga studentët për qëllime mësimore, kërkim shkencor, shfletimin e titujve on-line, punimin e detyrave të kursit, diplomave apo detyrave specifike në lëndët që zhvillojnë.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Orari i bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon nga e hëna në të premte, në orarin 08:00 – 21.00. Gjatë sezonit të provimeve në funksion edhe të kërkesës së studentëve, është e hapur në orar më të zgjatur.
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	AFA ka hartuar dhe zbaton një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës dhe përditësimin e fondit ekzistues [Evidencë 27], në përputhje me nevojat e programeve të studimit, si dhe analizon vazhdimisht shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe atij online nga personeli akademik dhe studentët duke marrë masa në funksion të saj.
Konkluzione	Në bibliotekën mësimore të AFA vihen në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik të programit të studimit Bachelor në "Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes", në format fizik dhe elektronik pa pagesë, literaturë bazë dhe ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, në përputhje

Hamaz

Genda

	me syllabuset e lëndëve, të cilat garantojnë marrjen e njohurive të parashikuara në programin e studimit. Pedagogët e lëndëve kujdesen të përgatisin materiale mësimore të përditësuara në gjuhën shqipe, të cilat vihen në dispozicion të studentëve. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën online EBSCO.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	AFA administron të gjithë informacionin, që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim, përmes platformës Pitagora e ofruar nga RASH [Evidencë 52]. Sistemi është një platformë, e cila krijon mundësinë e personalizimit sipas nevojave dhe specifikave të institucionit.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Për menaxhimin e dokumentacionit, institucioni përdor platformën e brendshme të intranetit “share folder”. Kjo platformë mundëson organizimin dhe menaxhimin efikas të informacionit, si dhe aksesin në të, në përputhje me hierarkinë përkatëse të përdoruesve përmes desktopit. AFA e përdor “share folder” jo vetëm për administrimin e dokumentacionit, por edhe për procesin mësimor në tërësi [Evidencë 22].
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Personeli dhe studentët e AFA përmes sistemit të menaxhimit platformën e brendshme të intranetit “share folder” kanë akses të dedikuar në informacione dhe dokumenta [Evidencë 22; Evidencë 52].
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar	Komunikimi ndërmjet personelit akademik dhe studentëve realizohet përmes Google Classroom. Përmes kësaj platforme,

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	realizohen diskutime, shkëmbehen ide dhe mendime, dorëzohen detyrat praktike gjatë orëve të mësimi, si dhe shpërndahet materiali mësimor i lëndëve përkatëse. Platforma lejon gjithashtu, ndërtimin e pyetësorëve, organizimin e punës në grup dhe komunikimin e vazhdueshëm. Ky sistem është konfiguruar dhe përshtatur sipas nevojave të institucionit nga grupi i brendshëm i zhvillimit, për të mbështetur në mënyrë efikase procesin mësimor dhe angazhimin studentor [Evidencë 61].			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Platforma Pitagora garanton monitorim në kohë reale të avancimit të studimeve të studentëve dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen web të AFA jepen informacione të detajuara dhe përditësuara lidhur me programet e studimit, stafin akademik të angazhuar, aktivitetet kurrikulare dhe ekstrakurrikulare. Faqja e institucionit është e disponueshme në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze (www.afa.mil.al dhe www.afa.edu.al).			
Konkluzione	AFA disponon platformën Pitagora e ofruar nga RASH, përmes të cilës administrohet të dhënat e studentëve dhe ecurinë e tyre akademike. Për menaxhimin e dokumentacionit, institucioni përdor platformën e brendshme të intranetit "share folder". Komunikimi ndërmjet personelit akademik dhe studentëve realizohet përmes Google Classroom. AFA disponon një faqe web-i në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Në web publikohet çdo informacion lidhur mbi institucionin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kamran

Georg

Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësishë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në rregulloren financiare të Institucionit [Evidencë 64, Neni 8] përcaktohet forma e raportimit financiar: 1. Njësitë shpenzuese të AFA-së ndërtojnë dhe mbajnë dokumentacionin financiar në përputhje me legjislacionin në fuqi, i cili përcakton parimet dhe rregullat e organizimit dhe mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. 2. AFA raporton në mënyrë periodike mujore gjatë vitit për veprimtarinë financiare pranë Senatit Akademik, Bordit të Administrimit, Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes. <i>Raportet financiare përgatiten në nivel institucioni dhe nuk ndahen sipas programeve të veçanta të studimit</i> [Evidencë 63].
Kriteri 2. Plani i financimit të njësishë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Plani i financimit hartohet në nivel institucional, duke përfshirë të gjitha kostot dhe të ardhurat e institucionit. Procesi i hartimit të buxhetit nis nga njësitë bazë, vazhdon me njësitë kryesore dhe më pas konsolidohet nga Rektorati. Plani i buxhetit vjetor i përgatitur në këtë mënyrë i përcillet fillimisht Senatit Akademik dhe më pas Bordit të Administrimit për miratim. Pas miratimit nga Bordi i Administrimit, buxheti hyn në fuqi dhe vihet në zbatim. AFA si institucioni publik i vetëm i arsimit të lartë me status të veçantë, financohet nga [Evidencë 64, Neni 6]: a) Buxheti i Shtetit Fondet buxhetore janë forma kryesore e financimit të AFA-së. Buxheti alokohet nga fondet buxhetore vjetore të miratuara për Ministrinë e Mbrojtjes. Nëpërmjet planifikimit buxhetor afatmesëm AFA paraqet kërkesat e saj për vitet në vijim. b) Të ardhurat e krijuara në institucion dhe financime të ligjshme, si: - të ardhurat e vjela nga të tretë në shërbime primare (mësimdhënie) si tarifa regjistrimi, tarifa shkollimi; - të ardhura sekondare, si tarifa shërbimesh; - të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; - të ardhurat nga veprimtaritë kërkimore – shkencore.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Auditimi në AFA kryhet nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Mbrojtjes, në bazë të një plani dhe grafiku të miratuar nga vetë Ministria. Pasqyrat financiare të institucionit publikohen çdo vit, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Kontabilitetin dhe Ligjit për QKB. Këto raporte pasqyrojnë me transparencë kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, ndarjen sipas llogarive përkatëse, si dhe vlerësimin e efikasitetit në përdorimin e fondeve për




	funksionimin institucional, rritjen e cilësisë në mësimdhënie, zhvillimin e kërkimit shkencor dhe ofrimin e shërbimeve për studentët. Në DVV është vënë në dispozicion raporti i auditimit financiar për vitin 2023, i hartuar nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Mbrojtjes [Evidencë 66]. Në këtë raport në përfundim të analizës audituese në Aneksin 2 janë lënë rekomandime për Institucionin me nivelet përkatëse të riskut.			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion në DVV dhe takimet në Institucion, GVJ vlerëson se Institucioni raporton mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës deri në njësinë kryesore dhe njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit.			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion në DVV dhe takimet në Institucion, GVJ vlerëson se Institucioni dëshmon qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programit të studimit dhe kapacitete financiare të mjaftueshme për gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme për vijueshmërinë e tij në të ardhmen.			
Konkluzione	<i>AFA dëshmon qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programit të studimit dhe kapacitete financiare të mjaftueshme për gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme për vijueshmërinë e tij në të ardhmen.</i> <i>GVJ rekomandon hartimin e raporteve financiare të detajuara në nivel programi studimi, njësie bazë dhe njësie kryesore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




				X
--	--	--	--	----------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ, nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion në DVV [Evidencë 3; Evidencë 7; Evidencë 2] dhe takimet në Institucion me studentë të këtij programi studimi, vlerëson se Institucioni zbaton politika dhe procedura, të cilat garantojnë të drejta të barabarta, për të gjithë kandidatët për studentë, duke mundur ndjekjen korrekte të kandidatit që nga momenti i aplikimit, më pas regjistrimit dhe deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomimin e tij.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Institucioni ka hartuar dokumentin “Politika dhe procedurat e rekrutimit të kandidatëve për oficerë të rinj në forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë” [Evidencë 4.18], i cili bazohet mbi parimet e: • paanshmërisë; • transparencës; • mosdiskriminimi; • objektivitetit në procesin e përzgjedhjes.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe	Në faqen web të Institucionit (https://www.afa.edu.al/studentet/566-studentet) bëhen të disponueshme për kandidatët për studentë informacionet e nevojshme: • <u>Kriteret e Pranimi;</u> • <u>Dokumentat që nevojiten për të aplikuar;</u> • <u>Si të aplikojme;</u> • <u>Mundësi punësimi;</u> • Këshilli Studentor; • Organizimet studentore; • Tarifat e studimeve; • <u>Legjislacioni.</u> Kandidatët për student në AFA duhet të jenë shtetas shqiptar (https://afa.mil.al/images/pdf/1_Kriteret_e_pranimi_ne_AFA.pdf). AFA bazuar në aktet nënligjore të MAS, si dhe në Marrëveshjen

Kawana

Gjuka

udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Dypalëshe me Republikën e Kosovës [Evidencë 68] pranon studentë nga Kosova.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Në rregulloren e programit të studimit jepen informacionet e nevojshme lidhur me kriteret e pranimit [Evidencë 2, Neni 16], të cilat bëhen publike për kandidatët e interesuar për studentë (https://afa.mil.al/images/pdf/1_Kriteret_e_pranimit_ne_AFA.pdf): <i>Minimalisht kandidati duhet të zotërojë:</i> • <i>Diplomë e maturës shtetërore të përfutur në RSH.</i> • <i>Diplomë e maturës shtetërore e përfutur jashtë dhe e konvertuar në sistemin e arsimit shqiptar.</i> • <i>Dëshmi/certifikata të njohjes së gjuhëve të huaja.</i> Kritere të tjera • <i>Nota mesatare e shkollës së kryer sipas VKM përkatëse dhe propozimit të njësisë bazë;</i> • <i>Kandidatët e kualifikuar dobët ti nënshtrohen intervistës me gojë;</i> • <i>Kandidatët fitues do të shpallen sipas rendit zbritës të pikëve të llogaritura me formulë sipas kriterëve përzgjedhëse;</i> • <i>Kriteret e veçanta për FA.</i> Kandidatët do të vlerësohen sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe konkursit institucional përmes një sistemi pikësh të përcaktuar [Evidencë 4.18], ku mbahen parasysh pesha specifike e notës mesatare, vlerësimi i testimit fizik, intervista dhe kontrolli shëndetësor. Në rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies [Evidencë 4.16.1, Neni 28] jepen informacione mbi njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e lëndëve: • <i>Njohja e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në AFA bëhet nga njësia bazë përgjegjëse për programin ose njësia kryesore, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore.</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të	Në faqet web të AFA (https://afa.mil.al/) dhe Ministrisë së Mbrojtjes (https://mod.gov.al) jepet informacion i përditësuar mbi kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit.




veçanta të programit të studimit.	
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	NA
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Kandidatët për student në AFA duhet të jenë shtetas shqiptar (https://afa.mil.al/images/pdf/1_Kriteret_e_pranimit_ne_AFA.pdf).
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	AFA ju ofron studentëve të saj trajtim të veçantë financiar, ushqimor, sportiv dhe didaktik. Studentët e ciklit të parë të studimeve <i>Bachelor</i> nuk paguajnë tarifë regjistrimi dhe përfitojnë një pagë mujore të garantuar gjatë gjithë periudhës së studimeve [Evidencë 67].
Konkluzione	<i>AFA ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura të qarta që mbulojnë gjithë ciklin akademik të studentëve, nga pranimi deri në diplomim, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Procesi i përzgjedhjes së studentëve bazohet në parime të transparencës, objektivitetit dhe mosdiskriminimit. AFA publikon dhe përditëson rregullisht kriteret e pranimi dhe informacionet përkatëse përmes faqes së saj zyrtare, duke garantuar akses të plotë për publikun dhe kandidatët e interesuar. Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për studentë janë të mirëpërcaktuara dhe përfshijnë gjithashtu mekanizma për vlerësimin e njohurive të mëparshme dhe transferimin e krediteve. Edhe pse pranimi është i kufizuar për shtetasit shqiptarë, në bazë të marrëveshjes dypalëshe me</i>

Ascal

Stafa

	<i>Republikën e Kosovës pranojnë edhe studentë nga Kosova. Institucioni ofron mbështetje të plotë financiare dhe logjistike për studentët e tij, në përputhje me natyrën ushtarake të institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Studentët e regjistruar pranë këtij programi studimi, njihen që në seancat e para të leksioneve, në takimet me koordinatorin e programit të studimit, pedagogët e lëndëve dhe sekretarinë mësimore mbi kriteret dhe procedurat e përparimit të tyre akademik.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Sipas përcaktimeve në rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies [Evidencë 4.16.1, Neni 28], njohja e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në AFA bëhet nga njësia bazë përgjegjëse për programin ose njësia kryesore, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Gjatë javës së parë të mësimin, në fillim të vitit akademik, studentët njihen me rregulloren e programit të studimit [Evidencë 2]. dhe syllabuset e lëndëve [Evidencë 4.2.2], ku ndër të tjera janë përcaktuar kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në bazë të kriterit të notës mesatare, studenti me notë mesatare mbi 7.5 ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një teze diplome, në të kundërt me provim të përgjithshëm përfundimtar formimi [Evidencë 2, Neni 27]. Studentëve, të cilët diplomohen me temë diplome ju vihet në dispozicion udhëzuesi i temës së diplomës [Evidencë 74]. Studentëve, të cilët diplomohen me provim të përgjithshëm provimi ju vihet në dispozicion baza e pyetjeve të formimit, si dhe mundësohen konsulta përgatitore.

Ilhamu

Gjuri

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Institucioni kujdeset në informimin e vazhdueshëm të studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit dhe mundësitë që lidhen me të, stafin akademik dhe infrastrukturën mësimore në dispozicion të programeve të studimit, përmes vizitave në shkollat e mesme, pjesëmarrjes në panairt “Work and study” të organizuara nga Dhoma e tregtisë në bashkëpunim me MAS, si dhe duke ftuar maturantët në ambientet e Universitetit [Evidencë 69].			
Konkluzione	<i>Studentët e regjistruar pranë këtij programi studimi, njihen gjatë javës orientuese dhe në seancat e para të leksioneve me kriteret dhe procedurat e përparimit të tyre akademik, me procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit dhe informacione të tjera të rëndësishme për mbarëvajtjen e studimeve të tyre.</i> <i>Institucioni kujdeset në informimin e vazhdueshëm të studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit dhe mundësitë që lidhen me të.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Gjatë javës orientuese, studentët e rinj informohen nga Dekani, Përgjegjësi i Njesisë Bazë dhe Personeli Akademik, në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes”, duke ju referuar rregullores së programit të studimit [Evidencë 2].
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	AFA vë në dispozicion të studentëve informacion të hollësishëm përmes faqes së saj web (https://afa.mil.al/), broshurave informuese dhe syllabuseve të lëndëve [Evidencë 4.2.2].




Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Studentët e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” punësohen menjëherë pasi përfundojnë studimet sipas Ligjit Nr. 59/2014 “Për karrierën Ushtarake në FARSH”. Zyra e personelit informon studentët mbi punësimin dhe i orienton studentët për vendet e punës se ku do të punojnë.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ nisur nga vizitat në Institucion me studentë të këtij programi studimi, vlerëson se Institucioni vë në dispozicion të studentëve në ambjentet e Universitetit dhe në faqen e saj <i>online</i> , të dhëna mbi orarin, aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, si dhe çdo informacion tjetër në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor. Sekretaria mësimore gjithashtu, kujdeset për informimin e vazhdueshëm të studentëve lidhur me zhvillimin korrekt të procesit mësimor.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	“Share folder” në dispozicion të AFA përdoret rregullisht për ndarjen e informacionit në kohë reale me studentët duke i mbajtur ata të përditësuar edhe në distancë [Evidencë 22].			
Konkluzione	<i>Studentët e regjistruar pranë këtij programi studimi, njihen që në seancat e para të leksioneve me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Ata informohen rregullisht mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor. Të diplomuarit në këtë program studimi punësohen menjëherë pasi përfundojnë studimet sipas Ligjit Nr. 59/2014 “Për karrierën Ushtarake në FARSH”.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore	Institucioni ruan dhe përditëson të dhënat për studentët nga regjistrimi i tyre deri në diplomim në “share folder” dhe përmes platformës Pitagora. Kjo mundëson realizimin nga ana

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	e personave të autorizuar të raporteve të ndryshme statistikore mbi vijueshmërinë, ndërprerjen, largimin dhe përfundimin e studimeve [Tabela përmbledhëse, Tabela 21, Tabela 23].
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” në vitin akademik 2021 – 2022, janë regjistruar 10 studentë dhe në vitin akademik 2022 – 2023, 9 studentë. Nga brezi i parë i studentëve të regjistruar, janë diplomuar, në vitin akademik 2023 – 2024, 10 studentë, të cilët janë të punësuar pranë FARSH [Tabela përmbledhëse, Tabela 21, Tabela 23].
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Përdorimi i platformës Pitagora garanton menaxhimin e informacioneve me siguri dhe i bën ato lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	FMS ndjek në mënyrë të vazhdueshme ecurinë akademike të studentëve të programit të studimit përmes regjistrave të lëndëve dhe të dhënave të mbledhura nga stafi akademik, që përfshijnë: prezencën në mësim, mungesat, pjesëmarrjen aktive, angazhimin në projekte, detyrat e kursit dhe vlerësimet periodike. Këto të dhëna do të menaxhohen dhe monitorohen në mënyrë më efektive përmes platformës Pitagora, e cila është në proces implementimi dhe do të mundësojë hedhjen dhe përditësimin e të dhënave nga stafi akademik. Përmes kësaj platforme, studentët do të kenë akses të drejtpërdrejtë për të ndjekur progresin e tyre akademik, për të parë vlerësimet, mungesat dhe të dhëna të tjera të rëndësishme gjatë gjithë vitit akademik.
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në	DTI harton çdo vit raporte analitike që mbulojnë fushat e ekspertizës së programit të studimit, cilësinë e studentëve në hyrje dhe dalje, si dhe shkallën e punësimit të tyre pas diplomimit [Analiza vjetore DTI]. Zyra e Këshillimit të




hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Karrierës, në bashkëpunim me Zyrën e Personelit të AFA, mban kontakte të rregullta me të diplomuarit, duke ndjekur ecurinë e tyre profesionale.		
Konkluzione	<i>Institucioni ruan dhe përditëson të dhënat për studentët nga regjistrimi i tyre deri në diplomim. Zyra e Këshillimit të Karrierës, në bashkëpunim me Zyrën e Personelit të AFA ndjek dhe ruan të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Studentët, gjatë ndjekjes së studimeve në AFA, kanë të drejtë [Evidencë 7, Neni 94]: - të përfaqësohen në organet e kolegjiiale të AFA, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe me këtë rregullore; - të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes së AFA, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe me këtë rregullore. Studentët e AFA kanë të drejtë të organizohen në Këshillat e studentëve [Evidencë 31]. Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve të AFA, të cilët përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e studentëve në të gjitha programet e studimit [Evidencë 7, Neni 97].
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të	AFA garanton përfshirjen e studentëve në procesin e vendimmarrjes përmes përfaqësuesve të tyre në senatin akademik, komisionet e përhershme, këshillin e etikës, NJBSC dhe mbledhjet e departamenteve. Përfaqësuesit e studentëve janë pjesë e GVB duke sjellë mendimin e tyre në hartimin e RVB, si dhe duke dhënë kontributin e tyre në procesin e vlerësimit të Institucionit.




verifikueshme e të matshme.	
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” nuk i është nënshtruar asnjë rishikimi apo përmirësimi gjatë periudhës 3 vjeçare të implementimit të tij. Në të janë regjistruar vetëm 2 breza studentësh. Institucioni ka planifikuar të kalojë drejt një programi të ri katërvjeçar në fushën e navigimit detar në kontekstin e mbrojtjes, në përputhje me modelet e vendeve partnere. Institucioni mban kontakte të vazhduara me studentët, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit të programit të studimit dhe pedagogëve gjatë orëve të mësimi, si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor [Evidencë 73]. Vlerësimi i studentëve për programin e studimit luan një rol të rëndësishëm në përmirësimin e syllabuseve të lëndëve dhe zhvillimin e orëve mësimore në përputhje me kërkesat e tyre duke rritur cilësinë e mësimnxënies.
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	1. Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin. Ankesa i drejtohet me shkrim Drejtuesit të Njesisë Kryesore ku bën pjesë studenti jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. 2. Drejtuesi i FMS kur e sheh të arsyeshme i kalon për shqyrtim kërkesën Përgjegjësit të Departamentit përkatës. Përgjegjësi i Departamentit, i cili vë në dijeni dhe personelin akademik të lëndës, pas shqyrtimit të kërkesës dërgon te Drejtuesi i FMS një relacion shpjegues. Në bazë të relacionit Drejtuesi i FMS vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës së studentit. 3. Në rastin kur kërkesa refuzohet studenti njoftohet për këtë vendim dhe për arsyet e refuzimit. 4. Në rastin kur kërkesa miratohet, Dekani ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës nëse lënda mbulohet nga vetë Departamenti. Në rast se lënda mbulohet nga një Njësi tjetër Kryesore, Drejtuesi i Njesisë Kryesore i kërkon kësaj njësie përbërjen e komisionit të ngritur nga Drejtuesi i asaj njësie. 5. Përgjegjësi i Departamentit përcakton ditën dhe orën se kur do mbledhet komisioni ad-hoc jo më vonë se 3 ditë nga miratimi i kërkesës dhe njofton për këtë orar personelin akademik të seksionit/grupit mësimor dhe studentin.

	6. Rishikimi i tezës nga komisioni ad-hoc realizohet në prezencë të studentit dhe personelit akademik të seksionit/grupit mësimor, nëse këta paraqiten në orarin e përcaktuar. Në përfundim të procesit, komisioni mban një procesverbal të veçantë ku pasqyron vendimin e tij për të ndryshuar ose jo vlerësimin e provimit së bashku me arsyetimin përkatës. 7. Në rast se ka ndryshim në vlerësimin e provimit atëherë ky ndryshim duhet të pasqyrohet në procesverbalin e lëndës duke ndjekur procedurat e përcaktuara në këtë rregullore. [Evidencë 2, Neni 28]			
Konkluzione	AFA mbështet dhe nxit pjesëmarrjen e studentëve në vendimarrje, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, të reflektuara edhe në aktet e tij të brendshme rregullatore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Njësitë përgjegjëse për informimin dhe ofrimin e shërbimeve për studentët janë Zyra e Sekretarisë Mësimore dhe Zyra e Personelit. Këto struktura ndjekin në mënyrë të vazhdueshme ecurinë akademike të studentëve, që nga momenti i regjistrimit deri në përfundimin e studimeve dhe diplomim. Ato ofrojnë mbështetje dhe konsulencë lidhur me çështje akademike, administrative dhe studentore [Evidencë 7].
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Institucioni përdor "share folder" për shpërndarjen e informacionit dhe është në proces implementimi të platformës Pitagora. Kjo platformë synon të përmirësojë informimin, këshillimin, ndjekjen dhe mbështetjen e studentëve në lidhje me ecurinë akademike, procesin mësimor dhe realizimin e programit të studimit.

Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Studentët e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” punësohen menjëherë pasi përfundojnë studimet sipas Ligjit Nr. 59/2014 “Për karrierën Ushtarake në FARSH”. Zyra e personelit informon studentët mbi punësimin dhe i orienton studentët për vendet e punës se ku do të punojnë.			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Sekretaria mësimore [Evidencë 51] dhe DAK ndjekin në bashkëpunim me strukturat përkatëse të FARSH punësimin e studentëve. Nga brezi i parë i studentëve të regjistruar në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes”, janë diplomuar, në vitin akademik 2023 – 2024, 10 studentë, të cilët janë të punësuar pranë FARSH [Tabela përmbledhëse, Tabela 21, Tabela 23].			
Konkluzione	AFA përmes Sekretarisë Mësimore, Zyrës së Personelit dhe Drejtorisë së Alumnit dhe Karrierës informon, ndjek dhe këshillon studentët gjatë gjithë ciklit të studimeve. Institucioni ka ndërmarrë hapa konkretë për përmirësimin e sistemit të informacionit përmes platformës Pitagora.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Institucioni ka hartuar një udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies [Evidencë 33], të cilat përshtaten me nevojat specifike të programeve të studimit të ofruara nga AFA. Ky udhëzues shërben si një kornizë orientuese për pedagogët, duke i udhëzuar drejt praktikave më të mira dhe duke mbështetur përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në procesin mësimor. Disa nga elementet kryesore të udhëzuesit janë: • Metoda inovative të mësimdhënies: Prezantohen qasje të avancuara si mësimdhënia e bazuar në projekte (PBL), mësimdhënia e bazuar në probleme (PBL), përdorimi i simulimeve, laboratorëve dhe platformave dixhitale ndërvepruese. • Përshtatja sipas fushës së studimit: Jepen rekomandime të personalizuara në përputhje me karakteristikat dhe kërkesat specifike të secilit program akademik, duke siguruar efektivitet të mësimdhënies në kontekste të ndryshme. • Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie: Ofron udhëzime praktike për integrimin e teknologjisë në mjedisin e të nxënit, përfshirë përdorimin e platformave online për menaxhimin e mësimin, mjeteve për bashkëpunim dhe komunikim, si dhe instrumenteve për vlerësim dixhital.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	DTI monitoron rregullisht procesin e mësimdhënies/mësimnxënies dhe atë të vlerësimit të studentëve dhe analizon periodikisht situatën duke propozuar përmirësime dhe duke ofruar mbështetje për stafin akademik. Në këtë kuadër një rëndësi të veçantë kanë edhe sugjerimet që vijnë nga studentët dhe të diplomuarit përmes kontakteve me ta, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorsit të programit të studimit dhe pedagogëve gjatë orëve të mësimin, si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor [Evidencë 73].
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e	Rezultatet e pyetësorit analizohen dhe bëhen diskutim në mbledhjet e Departamentit, asamblesë së Fakultetit dhe në senat, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të studentëve, duke evidentuar praktikën e mira dhe duke hartuar një plan masash




metodave të mësimit, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	për zgjidhjen e problematikave dhe përmirësimin e procesit mësues aty ku është e nevojshme.								
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimit bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Komunikimi dhe publikimi i rezultateve të vlerësimit kryhen në këto mënyra [Evidencë 71, Neni 25]: • Raportet e monitorimit u komunikohen organeve, strukturave dhe autoriteteve përkatëse të AFA; • Raportet e vlerësimit të brendshëm bëhen publike; • Raportet e vlerësimit të jashtëm bëhen publike; • Vendimet e akreditimit institucional dhe të programeve bëhen publike; • Vlerësimi i programeve të studimit, vlerësimi i lëndës dhe i mësimit publikohen në mënyrë të përmblodhur; • Raportet e vlerësimeve individuale të drejtuesve të njësive bazë, të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ u komunikohen individualisht individëve; • Rezultatet e vlerësimit të arritjeve u komunikohen individualisht studentëve; • Raportet e vlerësimit shkruhen sipas udhëzimeve të paraqitura në Manualin e Cilësisë së AFA.								
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimit.	DTI analizon gjithë problematikën që lidhet me procesin mësues dhe aktivitetin kërkues [Analiza vjetore DTI]. Informacioni i marrë nga pyetësi i studentëve janë objekt i një analize të thelluar që synon vlerësimin e rezultateve të marra, promovimin e praktikave të mira, si dhe nxitjes dhe inkurajimit të personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimit.								
Konkluzione	AFA monitoron rregullisht procesin e mësimit/mësimnxënies dhe atë të vlerësimit të studentëve dhe analizon periodikisht situatën duke propozuar përmirësime dhe duke ofruar mbështetje për stafin akademik.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table><tr><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr><tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr></table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.2

Iliriana

Gejtra

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në nivel Institucional, strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë janë [Evidencë 3]: - Senati Akademik; - Komisioni i Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulës; - Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë (DKSC) [Evidencë 71]: • Sektori i Zhvillimit të Kurrikulës; • Sektori i Cilësisë dhe Statistikave. AFA, përmes këtyre strukturave, synon monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe avancimit të kërkimit shkencor. Mbi bazën e raporteve të hartuara nga monitorimi, mbështeten praktikatat e mira dhe propozohen plan masash për praktikatat që kanë nevojë për përmirësim.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Strukturat e SC pranë AFA nxisin dhe mbështesin angazhimin në kuadër të sigurimit të cilësisë të stafit drejtues, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, studentëve të programit të studimit, si dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm.
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Në funksion të sigurimit të cilësisë në AFA kryhen veprimtaritë monitoruese si mëposhtë [Evidencë 71, Neni 7]: • monitorimi sistematik i respektimit nga AFA të kornizës ligjore dhe rregullatore; të kriterëve të kurrikulave; të kriterëve të pranimit të studentëve; të kriterëve të vlerësimit të studentëve; të kriterëve të pranimit dhe të performancës në punë të personelit akademik; ndihmësakademik dhe administrativ, të kriterëve të menaxhimit të institucionit, të kriterëve të menaxhimit të burimeve materiale dhe financiare; • monitorimi sistematik i treguesve të cilësisë së personelit akademik; • monitorimi sistematik i treguesve të cilësisë së studentëve; • monitorimi sistematik i treguesve të cilësisë së kërkimit shkencor;




	• monitorimi sistematik i treguesve të cilësisë së shërbimeve për studentët; • monitorimi sistematik i treguesve të infrastrukturës. Në funksion të sigurimit të cilësisë në AFA kryhen veprimtaritë e vlerësimit të brendshëm si mëposhtë [Evidencë 71, Neni 7]: • vlerësimi i brendshëm në nivelin e institucionit, të njësisë kryesore, të njësisë bazë; • vlerësimi i brendshëm për programet e studimit dhe mësimdhënien; • vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore; • vlerësimi i performancës së drejtuesve të njësive bazë, personelit ndihmësakademik, dhe administrativ; • vlerësimi i nevojave për trajnim të personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ; • vlerësimi i cilësisë së arritjeve të studentëve; • vlerësimi i nevojave të studentëve për shërbime akademike, ligjore, psiko-sociale.
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Vlerësimi i brendshëm bazohet në [Evidencë 71, Neni 24]: • dokumentet ligjore e rregullatorë, strategjike, dhe të tjera dokumente të AFA-së, të njësive kryesore, njësive bazë dhe njësive të tjera; • të dhënat nga sistemet e informacionit të AFA-së, njësive kryesore, njësive bazë, njësive të tjera ose burimeve të tjera publike; • treguesit e përcaktuar në Planin Strategjik të Zhvillimit të AFA-së, në Planin Strategjik të Kërkimit Shkencor dhe në Raportin vjetor të AFA-së. • vlerësimet e drejtuesve; • vlerësimet e ekspertëve; • vlerësimet e kolegëve; • vlerësimet e studentëve; • vlerësimet e të diplomuarve; • vlerësimet e bashkëpunëtorëve; • vlerësimet e punëdhënësve; • të dhënat e mbledhura nëpërmjet anketimeve, plotësimit të formularëve të vlerësimit, intervistave, fokus grupeve, vëzhgimeve, rezultateve të provimeve, të diplomimit; Procesi i sigurimit të cilësisë mbështetet nga Manuali i Cilësisë, Paketa e Instrumenteve dhe dokumentat e tjera udhëzuese të miratuara nga Senati Akademik.
Konkluzione	<i>Njësia përgjegjëse në AFA për sigurimin e cilësisë është Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë (DKSC) e</i>




	përbërë nga 2 sektorë: Sektori i Zhvillimit të Kurrikulës dhe Sektori i Cilësisë dhe Statistikave. NjBSC mbledh të dhënat statistikore dhe përcakton treguesit kyç të performancës për të analizuar kontributin e tyre ndaj arritjes së objektivave strategjike institucionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Institucioni në mënyrë periodike zhvillon pyetësorë me studentët mbi cilësinë e mësimdhënies, që lidhen me stafin akademik/lëndët e zhvilluara dhe pëlqyeshmërinë ndaj tyre [Evidencë 73]. Rezultatet e pyetësorëve analizohen nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë. Stafi akademik vihet në dijeni individualisht për pyetësorin, i cili lidhet drejtëpërdrejtë me performancën e tij. Pas analizës së pyetësorëve në nivelet përkatëse, dhe diskutimeve me personat e interesuar, Institucioni merr masa për zgjidhjen e problematikave. Institucioni organizon gjithashtu, mbledhje të hapura në të cilat marrin pjesë studentë, staf akademik dhe përfaqësues të tregut të punës, duke nxitur tek ata ndërgjegjësimin dhe rëndësinë e ruajtjes së cilësisë dhe nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm në përputhje me standardet e cilësisë.
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e	Në DVV është vënë në dispozicion Raporti për Rezultatet e Pyetësorit mbi Vlerësimin e Studentëve për Stafin Akademik për Vitin Akademik 2023-2024. Në të paraqitet një përmbledhje e rezultateve të pyetësorit në nivel Institucioni me pikat e forta dhe të dobëta dhe rekomandimet e lëna nga grupi i punës. Raportit i bashkëngjitet analiza më e detajuar e rezultateve të gjeneruara nga Google Forms [Evidencë 72].




mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Institucioni mban kontakte të vazhduara me studentët, në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes koordinatorit të programit të studimit dhe pedagogëve gjatë orëve të mësimi, si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor [Evidencë 73]. Informacionet e mbledhura nga këto instrumenta bëhen pjesë e diskutimeve në mbledhjet e Departamentit, asamblesë së Fakultetit dhe në Senat, me praninë e përfaqësuesve të studentëve, duke promovuar praktikën e mira dhe duke propozuar një plan masash për problematikat e evidentuara, duke synuar përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kurrikulave të programeve të studimit të ofruara, përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, përmirësimin e formave të vlerësimit të studentëve, etj.
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të	Diskutimet me alumnin në kuadër të përmirësimit të programeve të studimit apo shkëmbimit të eksperiencave janë të hapura dhe të vazhduara. Duke qenë se një pjesë e mirë e alumni bëhen pas diplomimit pjesë e forcave të armatosura mundësia e kontakteve dhe <i>feedback</i>-ut nga ana e tyre është e vazhdueshme.




studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.				
Konkluzione	<i>Institucioni monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike cilësinë e programit të studimit me metoda të drejtëpërdrejta dhe të tërthorta përmes Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, si njësi përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në kuadër të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes”, Institucioni nxit dhe garanton plotësimin e standardeve të cilësisë dhe përfshirjen e gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të tij në politikat dhe procedurat që lidhen me to.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në rregulloren për sigurimin e cilësisë në AFA [Evidencë 71] përcaktohen përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë e angazhuara në Sigurimin e Cilësisë, të tilla si Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm, Këshilli i Studentëve, drejtuesi i institucioni, drejtuesi i njësisë kryesore, drejtuesi i njësisë bazë etj.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së	Njësia bazë dhe kryesore, drejtuesit e tyre, personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik, si dhe studentët janë pjesë




programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	aktive në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Përfaqësues të tyre hartojnë RVB dhe përgatisin DVV në bashkëpunim me njësitë e ndryshme të Institucionit.			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Institucioni siguron përfshirjen aktive të personelit akademik dhe studentëve në proceset periodike të vlerësimit, duke respektuar parimet e integritetit akademik dhe barazisë. Të gjitha procedurat zhvillohen në mënyrë transparente, duke shmangur çdo formë diskriminimi apo trajtimi të pabarabartë.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, institucioni përfshin bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me programin e studimit ose ofrojnë ekspertizë të vlefshme për vlerësimin dhe përmirësimin e tij. Një vend të veçantë në këtë proces zë bashkëpunimi me FARSH, i cili garanton përputhshmërinë e programit me nevojat e tregut dhe kërkesat institucionale.			
Konkluzione	<i>FMS, DTI, personeli akademik, studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm të Institucionit janë pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5




Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Komunikimi dhe publikimi i rezultateve të vlerësimit kryhen në këto mënyra [Evidencë 71, Neni 25]: • Raportet e monitorimit u komunikohen organeve, strukturave dhe autoriteteve përkatëse të AFA; • Raportet e vlerësimit të brendshëm bëhen publike; • Raportet e vlerësimit të jashtëm bëhen publike; • Vendimet e akreditimit institucional dhe të programeve bëhen publike; • Vlerësimi i programeve të studimit, vlerësimi i lëndës dhe i mësimdhënies publikohen në mënyrë të përmbledhur; • Raportet e vlerësimeve individuale të drejtuesve të njësive bazë, të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ u komunikohen individualisht individëve; • Rezultatet e vlerësimit të arritjeve u komunikohen individualisht studentëve; • Raportet e vlerësimit shkruhen sipas udhëzimeve të paraqitura në Manualin e Cilësisë së AFA.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Në Raportin për Rezultatet e Pyetësorit mbi Vlerësimin e Studentëve për Stafin Akademik për Vitin Akademik 2023-2024 paraqitet një përmbledhje e rezultateve të pyetësorit në nivel Institucioni me pikat e forta dhe të dobëta dhe rekomandimet e lëna nga grupi i punës. Raportit i bashkëngjitet analiza më e detajuar e rezultateve të gjeneruara nga Google Forms [Evidencë 72]. Rekomandimet e lëna nga grupi i punës shërbejnë si një pikënisje për Institucionin për zgjidhjen e problematikave të ndryshme të evidentuara.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Analizat periodike [Evidencë 42] dhe ndërgjegjësimi për rëndësinë e ruajtjes së cilësisë mundësojnë përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për	Personeli akademik, ndihmës akademik dhe studentët janë pjesë aktive e procesit të vlerësimit. Informimi dhe ndërgjegjësimi i tyre për sigurimin e cilësisë është i vazhdueshëm, i drejtëpërdrejtë përmes përfshirjes së tyre në

informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë (GVB, pyetësorët, plani i masave etj.), dhe e tërthortë përmes përcjelljes së raporteve dhe diskutimit të tyre në takime informuese.			
Konkluzione	<i>Institucion është transparent me studentët dhe të gjithë të interesuarit lidhur me veprimtaritë në kuadër të SBC duke krijuar një kulturë të cilësisë brenda Institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Akademia e Forcave të Armatosura”

Pikat e forta dhe afirmime:

- Programi ndërthur kurrikulën civile me atë ushtarake, duke ofruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të integruar. Studentët pajisen me njohuri teknike, profesionale dhe teknologjike të avancuara, si dhe me kompetenca strategjike në fushën e mbrojtjes, duke i përgatitur ata për të përballuar sfidat komplekse të kohës.
- Studentët përfitojnë mbështetje të plotë financiare në formën e një page mujore, trajtimi ushqimor dhe shërbimeve të tjera të nevojshme. Ndjekja e këtij programi është pa pagesë.
- Punësimi i garantuar i të diplomuarve si oficerë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Pika të dobta:

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




- a. Numri i pedagogëve të angazhuar është i pamjaftueshëm për të përballuar ngarkesën akademike dhe multidisiplinaritetin e profilit të studimit (Standardi I.1, Kriteri 4; Standardi IV.1, Kriteri 2).
- b. Nevoja për përditësimin e kurrikulës me zhvillimet më të fundit ndërkombëtare të fushës (Standardi II.5, Kriteri 1).
- c. Mungesa e bashkëpunimeve konkrete në zhvillimin e këtij programi studimi me Institucione partnere ndërkombëtare (Standardi I.1, Kriteri 4; Standardi IV.1, Kriteri 2).

Rekomandime:

- a. Rekrutimi i personelit akademik sipas profileve dhe fushave të ndryshme të ofruara. Mbështetja e stafit të ri në marrjen e gradave shkencore dhe titujve akademikë. Trajnimi i tyre në përputhje me specifikat e programit të studimit dhe zhvillimet më të fundit të fushës.
- b. Përditësimi i kurrikulës në përputhje me zhvillimet më të fundit ndërkombëtare.
- c. Bashkëpunimi me institucione partnere ndërkombëtare për hartimin e kurrikulave të përbashkëta, shkëmbimin e eksperiencave, stafit dhe teknologjisë bashkëkohore.



Evaluation's conclusions for the first cycle study program *Bachelor "Naval navigation in defense"* provided by the Higher Education Institution "Armed Forces Academy"

Strengths and affirmations

- a. The program integrates both civilian and military curricula, offering a comprehensive and interdisciplinary approach. Students acquire advanced technical, professional, and technological knowledge, along with strategic competencies in the field of defense, preparing them to face the complex challenges of the modern era.
- b. Students benefit from full financial support, including a monthly stipend, meals, and other necessary services. Participation in this program is tuition-free.
- c. Guaranteed employment of graduates as officers in the Armed Forces of the Republic of Albania.

Weaknesses

- a. The number of academic staff involved is insufficient to handle the academic workload and the multidisciplinary nature of the study program (Standard I.1, Criteria 4; Standard IV.1, Criteria 2).
- b. There is a need to update the curriculum in line with the latest international developments in the field (Standard II.5, Criteria 1).
- c. There is a lack of concrete collaborations in the development of this study program with international partner institutions (Standard I.1, Criteria 4; Standard IV.1, Criteria 2).

Recommendation

- a. Recruitment of academic staff based on the profiles and fields offered. Support for new staff in obtaining scientific degrees and academic titles, as well as training aligned with the specifics of the study program and the latest developments in the field.
- b. Updating the curriculum in accordance with the latest international developments.
- c. Collaboration with international partner institutions for the development of joint curricula, exchange of experiences, academic staff, and modern technologies.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X